




**KUVENDI I KOMUNËS–SUHAREKË  
SKUPŠTINA OPSTINE - SUVA REKA  
MUNICIPALITY OF SUHAREKA**



**Procesverbal XII/2024**

**I mbajtur me rastin e mbledhjes së 12 (dymbëdhjetë) për vitin 2024 të Kuvendit të Komunës së Suharekës**

---

**Vendi: Suharekë**  
**Zyra: Salla e Kuvendit të Komunës**  
**Data: 23.12.2024**  
**Ora: 10.00**

---

**Prezentë në takim:**

**Z. Shefket Kolgeci**  
**Z.Selman Kolgeci**  
**Z. Flamur Bytyçi**  
**Z. Urim Suka**  
**Z. Kushtrim Kuçi**  
**Znj. Elmaze Bytyqi**  
**Znj. Bulëza Kuçi**  
**Znj.Doruntina Zenelaj**  
**Z.Alban Berisha**  
**z.Xhevshet Gashi**  
**Z. Bexhet Kuçi**  
**Z. Reshat Selimaj**  
**Z. Lirim Qatani**  
**Z. Aziz Bytyqi**  
**Znj.Sanie Kuçi-**  
**Rexhepaj**  
**Znj.Fidaije Kukaj**

**Të pranishëm tjerë:**

**Kryetari i Komunës**  
**Media dhe qytetarë**  
**OSCE, LMT, KDI**  
**Znj.Habibe Bytyqi**  
**Z.Xheladin Sadikaj**

**Znj. Afërdita Morina**  
**Z. Vullnet Luzhnica**  
**Z.Edon Sadikaj**  
**Znj.Saranda Bajraktari**  
**Znj.Mimoza Bajraktari**  
**Znj.Festë Kabashi**  
**Z.Dardan Berisha**  
**Z.Bajram Basha**  
**Znj.Mevlude Kabashi**  
**Znj.Sheqerije Zyrapi**  
**Znj.Laureta Tafaj**  
**Z.Liridon Fandaj**  
**Z.Qëndrim Elshani**  
**Z.Herolind Limaj**  
**Znj.Jehona Lumi-**  
**Rrafshi**

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Asamblesë Komunale z.Bexhet Kuçi,i cili propozoi këtë:

### **REND DITE**

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis në Komunën e Suharekës;**
- 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e planit vjetor të punës për Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi;**
- 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e planit vjetor të punës i Kuvendit të Komunës në Suharekë;**
- 5. Pyetje dhe përgjigje;**

**Kryesuesi** - përshëndet të pranishmit dhe thotë që është një pikë shtesë të cilën iu kemi dërgu në email.Është raporti i performancës së Komunës së Suharekës për periudhën janar-dhjetor 2023.E hedh në votim pikën shtesë.

**20 për, 1 kundër,5 apstenime  
Miratohet pika shtesë**

**Kryesuesi** - e hedh në votim rendin e ditës me pikën shtesë.

**20 për,1 kundër,4 apstenime  
Miratohet rendi i ditës me pikën shtesë**

**Pika 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kalaura;**

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 1.

**Unanimisht Miratohet**

**Pika 2.Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis në Komunën e Suharekës;**

**Kryesuesi** - e elaboron pikën dhe hap debatin.

**Qëndrim Elshani** - në emër të grupit të LVV-së shpreh keqardhje për këtë ekzekutiv dhe për mospërgjegjësinë e tyre për me i përgaditë të paktën kushtet për këtë mbledhje.Këtu është ekstrem ftohtë dhe gjithëashtu edhe seancën e kaluar ka qenë shumë ftohtë dhe keni thënë që do të rregullohet mirëpo nuk është rregullu.Meritatat e paqena i ka marrë ekzekutivi në krye me Kryetarin Muharremaj për ndërtimin e këtij objekti.

**Kryesuesi** - jeni në pikë të rendit të ditës dhe të lutem mos dil jasht temës.

**Qëndrim Elshani** - përpos që i ka marrë meritat edhe pse nuk ka pas pothuaj asgjë në dorë,të paktën duhet me mirëmbajt si duhet dhe unë propozoj që këtë mbledhje me shty për një ditë tjetër,kur do që bëhen kushtet për me mbajtë si duhet mbledhjen sepse nuk jemi në periudhë të jashtëzakonshme për me mbajtë patjetër në këtë moment mbledhjen.

**Urim Suka** - I bashkohem shqetësimit që ka Qëndrimi.Vërtetë kushtet në të cilat jemi duke punu sot janë shumë shqetësuese.Unë po çuditem se pse ky objekt nuk është nxeh sepse përveq nëse nuk punon nxemja këtu,ka pas edhe mundësi alternative për me nxeh sepse objekti nuk është aq i madh.

Sa i përket pikës që po flasim, njëjtë edhe këtu vërehet një papërgjegjësi e pushtetit në përgjithësi në gjithë këtë periudhë që ju keni vazhdu me udhëheq. Sot kemi një plan për mjedis i cili për neve dhe si çdo ide që komuna duhet me pas plane të tilla, ne i kemi dhënë mbështetje mirëpo ajo që më shqetëson është se ne po miratojmë plane dhe pastaj aktivitetet e juaja në teren dalin përtej këtyre planeve dhe kurrë nuk lexohen këto plane. Ne në parim si LDK do ti japim mbështetje këtij projekt-vendimi por do të kërkojmë më shumë përgjegjësi prej juve që këto plane që i miratojmë ne dhe për shkak të bazës ligjore që komuna duhet me i pas, unë mendoj që duhet ta kthejmë kokën te këto plane dhe pastaj veprimtaria e juaj në drejtoritë e caktuara të bazohet në këto plane.

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 2.

## 24 për, 4 apstenime, Miratohet pika 2

### **Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e planit vjetor të punës për Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi;**

**Kryesuesi** - e elaboron pikën dhe hap debatin. Nuk ka debat, e hedh në votim pikën 3.

## 25 për, 3 apstenime, Miratohet pika 3

### **Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e planit vjetor të punës i Kuvendit të Komunës në Suharekë;**

**Kryesuesi** - e elaboron pikën dhe hap debatin.

**Urim Suka** - përshëndet të pranishmit. Kur jemi te plani i punës së Kuvendit, unë mendoj që ky dokument na orienton pak a shumë për rrugën që ne si kuvend duhet të kemi në vitin e ardhshëm për punën që do të bëjmë por ajo që më shqetëson është që shumë gjëra të një rëndësie të veçantë në këtë plan që ne e miratojmë, figurojnë, kur fillon implementimi pastaj këto gjatë rrugës nuk realizohen. Mendoj që ne si kuvend i komunës, mbi partitë politike si asambleista që kemi marrë mbështetjen e qytetarëve, është mirë që t'kemi fokus kryesor që të paktën çështjet bazike që duhet ky kuvend me i përmbush, m'i përmbush dhe të gjithë e dimë që roli jonë është një lloj mbikqyrës i punës së ekzekutivit dhe në rastin tonë konkret në shumicën e rasteve ne nuk kemi arrit si kuvend me bo më të mirën e mundëshme që me qenë si një mbikqyrës i këtij ekzekutivi. Edhe në planin paraprak ka qenë një pikë ku Kryetari i Komunës duhet me raportu para Asamblesë për punën e tij, për mënyrën se si po shkojnë projektet, si po ekzekutohet buxheti por në fakt ne që tre vite sa jemi në Asamble nuk e kemi pas një raport të Kryetarit të komunës i cili duhet me dhënë llogari edhe mbi bazën e ligjit. Ligji për vetqeverisje lokale neni 58 pika J e përcakton që Kryetari i komunës dy herë në vit së paku duhet me raportu në Kuvendin e komunës dhe kjo s'ka ndodh asnjëherë. Edhe në Statusin e komunës, neni 45 pika H e përcakton një gjë të tillë e që në fakt nuk është duke ndodh. Diskutim tjetër është edhe te raporti i DKA-së, e cila është dasht të raportoj para kuvendit gjatë muajit gusht për aktivitetet e saj dhe për përgaditjet që janë bë, dhe ajo nuk ka raportu. Në anën tjetër, në dhjetor ka qenë e parapane raporti për monitorimin dhe zbatimin e PZHK-së dhe HZK-së dhe në këtë plan figuron ky raport por në fakt prej se jemi në Asamble asnjëherë s'ka ardhë ky raport. Specifikisht Sania në KPF dhe në Asamble ka kërku me ardhë ky raport por kurrë nuk ka ardhë dhe me sa unë e di është bazë ligjore që duhet me raportu për zbatimin e PZHK-së dhe HZK-së. Këto pika janë vetëm disa që figurojnë edhe në planin e punës që ne kemi me miratu por ajo që po ndodh pastaj është që këto raporte nuk po vijnë dhe unë mendoj që ne si Kuvend duhet me kërku llogari prej drejtorave dhe Kryetarit të cilët e kanë obligim me raportu në bazë të ligjit. Unë mendoj që Kuvendi duhet me pas një plan të punës dhe do ti japim mbështetje por po kërkojmë që secili prej ekzekutivit dhe ne si Asamble ti marrim për bazë këto dhe raportet të na vijnë në afate kohore. Kërkoj nga Visari të na tregoj se pse nuk ka ardhë ky raport.

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 4.

## 27 për, 3 apstenime, Miratohet pika 4

## **Pika 5 shtesë: Raporti i performancës së Komunës së Suharekës për periudhën janar-dhjetor 2023;**

**Kryesuesi** - kërkoj mirëkuptim për pikën shtesë por kjo pikë u kërku vetëm që mos ti humbim 5 pikë si Komunë. Kryesuesi elaboron pikën dhe hap debatin.

**Urim Suka** - pak a shumë jam mundu ta lexoj raportin në vija të trasha dhe vërtetë jam i çuditur për vlerësimin që është bërë. Paramendoni, fusha 2-transparenca publike 100 pikë! Kisha pas dëshirë me m'dëgju ata që e kanë bërë këtë raport. Këtu në Asamble secili prej nesh kemi kërku shumë raporte, shumë kërkesa dhe kemi dërgu emaila me shkrim atje dhe s'kemi marrë përgjigje ndërsa këtu thotë: transparenca 100 pikë. Më kujtohet raporti prej Drejtorisë së Kulturës të cilin e pata kërku tri mbledhje deri sa ka ardhë, dhe kur ka ardhë, nuk ka ardhë as 30% sipas kërkesës që e kam bërë. Planifikimi hapsinor 100 pikë. Por a nuk e dimë ne se çka po ndodh me planifikimin hapsinor? Realiteti i këtyre pikëve nuk është askund me atë që është në teren që secili qytetar e përjeton. Fusha 8 Hapësirat publike 100 pikë. A nuk e dimë ne se sa janë të uzurpuara hapësirat publike? Fusha 9 Infrastruktura rrugore 93.20 %. Realiteti është që 3 milion apo 4 milion këta vet kanë thënë që i ka marrë përmbaruesi dhe ka u arrit kjo 93 %! A e din çka kanë heq qytetarët në rrugën Skënderbeu, te sheshi. E fundit dhe këtë që ju nuk keni mund të ndikoni, keni dal e 25-ta me 37.90%. Zanin që e ngrita këtu, më shqetson që ata që kanë vlerësuar dhe më shqetëson përpjekja juaj që keni qu letra atje dhe keni bo dokumente që nuk janë askund në teren me realitetin sepse realitetin e dinë të gjithë qytetarët dhe ky dokument që e ka bërë ministria askund me realitetin nuk është. Nëse ju thoni që kjo që po flas unë , nuk është në rregull atëherë qohi dhe e formojmë një komision dhe dalim e shohim se çka ka ndodh në teren.

**Kryesuesi** - të jemi të qartë që këtë raport nuk e ka përgadit pushteti lokal por e ka përgadit MAPL-ja.

## **Pika 6. Pyetje dhe përgjigje.**

**Urim Suka** - shqetësimin që e kam është për Kryqin e Kuq që e kemi diskutu në seancën e kaluar dhe në KPF dhe pak a shumë janë shterru çështjet që lidhen me këtë sepse edhe në KPF ju keni thënë që nuk ka bazë ligjore që Kuvendi me marrë një vendim të tillë. Mirëpo unë jam i detyruar me ngrit këtë shqetësim të Kryqit të Kuq sepse pas asaj që kemi diskutu në KPF jam interesuar pak më shumë në detaje për me pa se cila është mundësia me i dal në ndihmë Kryqit të Kuq. Unë them që Kryqin e Kuq nuk duhet me trajtu sikurse çdo OJQ. Unë u interesova dhe pash që Komunua Suharekës vite më parë ka arrit një marrëveshje mirëkuptimi mes komunës dhe Kryqit të Kuq dhe e kanë bërë një renovim një herë, me sa e di por praktika të tilla të marrëveshjeve të bashkpunimit ose mirëkuptimit për bashkfinancim kish edhe në komunat tjera dhe unë i kam këtu disa prej tyre. Unë kërkoj me shku me vizitu Kryqin e Kuq, me pa problemin që ka ndodh dhe me u ul me ndërto një marrëveshje të mirëkuptimit bashkë me ta dhe me bo një fond pastaj që ata me mujt me i rregullu ato probleme që ju kanë dalë. Ju lus ta merrni seriozisht çështjen, ti dilni në ndihmë sepse Kryqi i Kuq është një organizatë që iu bënë shërbime njerëzve e sidomos familjeve në nevojë.

**Kryesuesi** - e kemi diskutu në KPF dhe jemi për me i ndihmu por e kemi zyrtarin ligjor dhe ia jap fjalën që ta elaboron çështjen se si është procedura dhe sa kemi të drejtë.

**Avni Bytyqi** - përshëndet të pranishmit. E kemi diskutu në mbledhjen e kaluar çështjen e Kryqit të Kuq dhe në KPF e kam dhënë një sqarim ligjor. Kryqi i Kuq është organizatë joqeveritare dhe si të gjitha organizatat tjera edhe Kryqi i Kuq mund të aplikojë kur komuna bën thirrje publike për subvencionimin e OJQ-ve. Këtë që e kërkoje ti Urim që me marrë vendim kuvendi për me i ndihmu Kryqit të Kuq, nuk ka bazë ligjore për arsye se OJQ-të subvencionohen vetëm përmes rregullores 04/2017 për subvencionimin e OJQ-ve ndërsa sa i përket çështjes së marrëveshjes që a mund ta bëj komuna, kjo është temë tjetër mes ekzekutivit dhe OJQ-ve që a me vazhdu me marrëveshje apo me vazhdu me procedure tjetër siq e kërkon procedura ligjore e ligjit për procedurat e prokurimit.

**Selman Kolgeci** - po e përsëris pyetjen e seancës së kaluar për DSHPE z. Enver Shabani. A është respektu ndërtimi i kyçjeve në rrugën "Skënderbeu" në raport me gjatësinë e asaj rruge? Po besoj që kjo do ti

shërbente shumë mirë raportit të performancës nëse sot e marrim një përgjigje meqenëse nuk e kemi marrë deri sot, mendoj transparencës komunale meqenëse e diskutuam që i kemi marrë 100 pikë këtu.

**Enver Shabani** - përshëndet të pranishmit. Ke kërku me formu një komision për auditimin e rrugës “Skënderbeu”. Ne nuk kemi formu komision, nuk bëjmë auditime por përgjigjen që mund ta them është kjo: komuna e Suharekës i ka udhëheq të gjitha procedurat për projektimin dhe ndërtimin e rrugës “Skënderbeu”. Projekti është i punuar nga një kompani dhe është duke ekzekutu në përpikmëri sipas projektit dhe projekti i parasheh daljet-kyçjet andaj dhe janë të parapara ashtu. Unë e thash që nuk ka marrë drejtë për së drejti në komision për vlerësim të auditimit dhe nuk do ta bëjmë këtë sepse nuk kemi ndoshta edhe kompetencë ne për të bë një auditim për vlerësimin e rrezikut në trafik të komunikacionit që zhvillohet në rrugën “Skënderbeu” por sipas planit të mobilitetit thuhet që me kalimin e kohës do të shqyrtohet dhe të mbyllet të gjitha kyçjet ose hyrje-daljet në atë segment por deri sa është në realizim projekti nuk kemi të drejtën të ndërhyjmë në projekt.

**Selman Kolgeci** - nuk ka qenë pyetje vetëm ndërtimi i kyçjeve aty por shqetësim i joni ka qenë siguria në përgjithësi në atë rrugë, çoft gjerësia e trotuareve, çoftë mundësia e aksidenteve aty. Drejtori po e përmend Planin e Mobilitetit të Qëndrueshë Urban dhe në këtë plan shenon saktë që kthimet majtas nuk lejohen.

**Enver Shabani** - projekti i rrugës “Skënderbeu” është bërë para Planit të Mobilitetit dhe e thashë që projekti do të ekzekutohet sipas projektit dhe pas përfundimit të projektit, thashë që, kush do që e bën Planin e Mobilitetit e shih të arsyeshme ose jo mbylljen e kyçjeve sikur që është e paraparë me plan të mobilitetit sepse Plani i Mobilitetit nuk shih kyçje.

**Selman Kolgeci** - nuk është praktika e parë që ndërhyret në projekt, ndërhyret ku do, ku do në botë projektet pësojnë ndryshime në të mirë të funksionimit të atij investimi. Ne nuk mund të bëjmë sot një diçka që e dimë që është rrezik permanent sidomos për këmbësorët aty për shkak të trotuarit të ngusht. Projekti mund të revidohet në shumë faza dhe lejohet me ligj me u revidu dhe me u ndryshu. Për atë them që mos ta bëjmë një diçka që ka me qenë rrezik permanent për këmbësorët dhe mundësi e madhe e numrit të aksidenteve në atë rrugë. Nuk kemi thënë me bë auditim por kemi thënë që a është respektu numri i kyçjeve në raport me gjatësinë e rrugës.

**Enver Shabani** - menaxheri i projektit nuk ka kërku ndonjë revidim dhe askush tjetër nuk ka kërku. Do të vazhdohet me punimet ashtu si është e paraparë dhe pas disa muajve do të bëhet vlerësimi se a ka aksidente ose jo dhe pas vlerësimit është Plani i Mobilitetit. Drejtori tutje jep sqarime.

**Elmaze Bytyqi** - përshëndet të pranishmit. Unë e përkrahi dhe mbështes propozimin dhe kërkesën e Urimit për ndihmesën ndaj Kryqit të Kuq. E di sepse aty jam e pranishme dhe jam anëtare dhe e di që Kryqi i Kuq ka nevojë sepse të gjitha paisjet elektrike janë djeg nga rryma. E cek Avniun që bën përmes subvencioneve. Për këto subvencione Kryqi i Kuq bën projekte mirëpo projektet bëhen me investime specifike dhe nuk bëhen projekte për me ble paisje elektrike.

**Urim Suka** - unë e kuptoj Avniun por unë shikova se cila është baza ligjore për m’i dal në ndihmë Kryqit të Kuq dhe baza ligjore për m’i dal në ndihmë Kryqit të Kuq është përmes një marrëveshje mirëkuptimi mes komunës dhe Kryqit të Kuq dhe është në vullnetin e tuaj si ekzekutiv a doni me i ndihmu asaj organizate apo nuk doni. Sa i përket ligjit për OJQ-të, veprimtaria e Kryqit të Kuq rregullohet edhe me një ligj të veçantë.

**Jehona Rrafshi** - përshëndet të pranishmit. Është shumë shqetësuese se pse kolegët asambleist të PDK-së dhe VV-së e lirojnë sallën. Është shumë e rëndësishme të jemi këtu për qytetarët pasi jemi të thirrur dhe e kemi obligim e jo ta lirojmë sallën për shkak që nuk ndihemi komod për shkak të temperaturave sepse temperatura është e njejtë për të gjithë. Në emër të partisë Nisma Social Demokrate dhe në emrin tim personal uroj të gjithë qytetarëve të komunës së Suharekës Vitin e Ri, shëndet e gjitha të mirat.

**Nënkryetarja** - përshëndet të pranishmit. Ne të gjithë e dimë rëndësinë e Kryqit të Kuq dhe në çfarë situata ka ndihmu. Ne si qeverisje jemi shumë të interesuar ti ndihmojmë Kryqit të Kuq, gjithmonë i kemi ndihmu dhe do ti ndihmojmë përsëri për arsye se ato paisje nuk janë paisje luksoze por janë mjete pune që duhet ti ndihmojmë dhe do të gjejmë mundësinë ose formën që të restaurohen ose të blehen të reja ato paisje. Nuk ka qenë asnjëherë diskutabile që të mos i ndihmohet.

**Alban Berisha** - përshëndet të pranishmit. Shumë prej pikave sot që u diskutuan, normal kam pas material shumë për me fol, edhe vërejtje dhe sugjerime. Kryesues, një shenjë proteste të llogaridhënia. Singërisht nuk po ndihem mirë kur po bëhet viti 7 ose 8-të që jam në Asamble dhe për çdo fundvit kur kanë ardhë disa pika, i kam pas disa vërejtje dhe nuk do të thotë që vërejtjet e mia kanë qenë gjithmonë me vend por është e drejta ime themelore është me shpreh mendimin tim. Fakti që më shqetëson është që të paktën me marrë një përgjigje dhe me thënë që nuk ke mirë sepse nuk bëhet kështu por vetëm me m' shiku në sy për atë që po e them dhe u kry ky muhabet dhe vjen viti tjetër, përsëritet e njëjta gjë. Po i bie që ky institucion ku jemi duke marrë pjesë ne, më shumë po më duket si një lloj teatri ku duhet me ardhë me luft rolin dhe me thënë atë që e kam mendu me thënë dhe aq. Dua ta marr një shembull. Kur kam reagu vitin e kaluar për shtëpizat në shesh, u kanë gati edhe prej ekzekutivit një farë miratimi që ka qenë një planifikim i keq dhe ka qenë keq. Ka fol Albani, u kanë keq dhe aq. Ndoshta në situata të caktuara kjo shfrytëzohet edhe politikisht që me shku m' i thënë 10 apo 15 bizneseve që është dikush i LDK-së kundra juve dhe ne po ju ndihmojmë bizneseve. Është një shenjë proteste Kryesues që nuk po di më pse me dhënë vërejtje sepse nuk po ka përgjigje. Unë e mora vetëm një shembull sepse kam shumë vërejtje tjera. Në situata të caktuara shumica e drejtorave edhe pse flet dikush prej neve, i kapin telefonat. Përkundrazi na është rrit paga kurse vlera jonë është duke ra në nivelin nën zero, po flas për këtë Asamble. Kryesues, për 2025-tën mos lejo që t' është një teatër por puno që të është një Asamble e vërtetë dhe përgjegjshmëria të është shumë më e madhe prej ekzekutivit dhe të paktën të përgjigjen. Urime Viti i Ri të gjithëve

**Kryesuesi** - ato që potencove ti, drejtorat në shumicën e rasteve t' u kanë përgjigj dhe jo vetëm ty por edhe të tjerëve ju kanë përgjigj. Shpresoj që vitin e ardhshëm të jetë një bashkëpunim edhe më të mirë mes ekzekutivit dhe legjislativit dhe unë i falemderoj anëtarët e kuvendit, drejtorat sepse kemi pas një bashkëpunim të mirë për vitin 2024 dhe ju uroj suksese të gjithëve.

**Nënkryetarja** - përshëndet të pranishmit. Më lejoni që në këtë fundvit të vitit 2024 të ju falemderoj në emër të Kryetarit të Komunës së Suharekës për angazhimin tuaj, bashkëpunimin, kontributin tuaj në gjithë zhvillimet tona që kemi bërë e qëllimi kryesor i të gjitha punëve tona ka qenë mirëqenia e të gjithë qytetarëve të komunës së Suharekës. Andaj në emër të Kryetarit të Komunës Bali Muharremaj i cili sot për momentin nuk është dhe e ka nënshkruar një kontratë në vlerë prej 1 milion euro ku jemi përfitues si komunë nga fondi i Kosovës për efikasitet të energjisë dhe përfitues të këtij fondi do të jenë shkolla "Skënder Luarasi", shkolla "Flamuri i Arbrit" në Reshtan dhe shkolla "Shkëndia". Të gjithëve ju uroj shëndet, suksese dhe harmoni për vitin 2025!

**Aziz Bytyqi** - sa i përket Kryqit të Kuq, dy herë e kam ngritur si çështje dhe për hir të vërtetës ka pas vullnet dhe ka vullnet për m' i ndihmu Kryqit të Kuq. Unë personalisht jam vullnetar i Kryqit të Kuq që nga viti 2007. Në seancën e kaluar arrita ta marr pëlqimin e kolegëve që në kuadër të një vendimi që ishte për me iu ndihmu 3 familjeve që kanë pësuar fatkeqësi, të hyjë në atë grup edhe çështja e Kryqit të Kuq por pastaj zyrtari ligjor na informoi që ka mospajtueshmëri ligjore dhe tash jam dakord me atë që tha Urimi. I uroj të gjithëve një vit të mbarë dhe të suksesshëm. Pasi jemi në prag të zgjedhjeve i uroj të gjithë kandidatëve që janë në garë nga komuna jonë, shëndet e suksese!

**Urim Suka** - po përmbillet një vit tjetër me shumë aktivitete, shumë angazhime, shumë çështje që kemi ngritur e të gjitha këto qëllim të vetëm kanë pas që secili prej nesh me përmbush mandatin të cilin e kemi marrë për me i përfaqësu qytetarët këtu dhe asnjë çështje që kemi ngritur nuk kanë pas qëllim personal ndaj asnjërit prej jush dhe asnjërit që është jashtë kësaj sale por qëllimet tona kanë qenë për me e rrit qeverisjen sepse kemi mendu që ka pas shumë probleme në vazhdimsi qeverisja. Unë e falemderoj secilin asambleist dhe ekzekutivin për bashkëpunimin, për mospajtimet që kemi pas. Uroj që viti që po vjen, të jetë një vit sa më i mirë për të gjithë qytetarët, për të gjithë ju dhe fokus kryesor ta kemi qytetarin dhe mirëqenien e tyre.

**Labint Halitjaha** - falemderojmë të gjithë asambleistat për korrektësinë, mirësjelljen dhe bashkëpunimin që keni bërë për këtë vit dhe ju uroj një vit të mbarë për vitin 2025 për ju dhe familjet tuaja në emrin tim dhe të PDK-së.

Takimi përfundoi: 11:00

Procesmbajtësja: Dafina Haziraj